

# AKT - THEMELIMI I SHOQËRISË TREGTARE “G&G Volatili” sh.p.k

Sot, më datë 01.06.2021 (dymijë e njëzet e nje) në themeluesit e shoqërisë:

- Flutura Nuredini, e bija e Muharemit dhe Kies, lindur në datë 24.01.1970 në Berat, pajisur me Dokument Identifikimi me Nr. 033412568, madhore me zotësi të plotë për të vepruar.
- Giani Riccardo, shtetas italian, i biri i Giovanni dhe Angela, lindur në datë 23.08.1965 në Vimercate, pajisur me Dokument Identifikimi me Nr. AY 4818925, madhor me zotësi të plotë për të vepruar.

Në bazë të vullnetit tonë të lirë dhe të pakushtëzuar, në mbështetje të Ligjit Nr.9901 dt.14/04/2008, “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare”, kemi vendosur të themelojmë Shoqërinë Tregtare “G&G Volatili” sh.p.k, sipas përcaktimeve të bëra në Akt-Themelimi dhe Statut.

## Neni 1- FORMIMI

Formohet Shoqëria Tregtare me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin “G&G Volatili” sh.p.k me dy ortakë themelues, Z. Giani RICCARDO dhe Znj.Flutura NUREDINI.

## Neni 2 - SELIA

Shoqëria Tregtare “G&G Volatili” sh.p.k e ka selinë ligjore në adresen: Rruga Eduart Mano, Pall 10, Njesia administrative nr 13, Tiranë, me të drejtë për të ndryshuar qendrën e saj si dhe për të hapur degë dhe filiale të tjera në të gjithë Republikën e Shqipërisë si dhe jashtë saj në përputhje me Legjislacionin Shqiptar

## Neni 3 - KOHËZGJATJA

Shoqëria Tregtare “G&G Volatili” sh.p.k ka një kohëzgjatje të veprimtarisë së saj ekonomike të pakufizuar.

## Neni 4 - OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Objekti i veprimtarisë ekonomike i Shoqërisë Tregtare “G&G Volatili” sh.p.k është përcaktuar me hollësi në nenin 2 te Statutit të kësaj shoqërie. Kështu konkretisht kjo shoqëri do të ushtrojë aktivitetin e saj në fushën:

1. Import - eksport i produkteve për dezinfektimin deratizim e dezifektim, pastrim e higjienizim dhe tregëtimi i tyre me shumice dhe pakice.

- Import - eksport i produkteve për dezinfektimin deratizim e dezifektim, pastrim e higjenizim dhe tregëtimi i tyre me shumice dhe pakice.
- Prodhimi i produkteve dhe pajisjeve që shërbejnë për dezinfektimin dezisektim dhe deratizim. Prodhimi i produkteve dhe materialeve që shërbejnë për largimin (alontanamento dei pigioni) e zogjeve dhe në vecanti pellumbave
- Dhënia me qera e mjeteve dhe pajisjeve që shërbejnë për dezinfektimin deratizim e dezifektim, pastrim e higjenizim.

## **Neni 5 - KAPITALI I SHOQËRISË**

Kapitali themeltar i Shoqërisë Tregtare **“G&G Volatili” sh.p.k** është **100 000** (njëqind mijë) lekë, i cili është nënshkruar dhe shlyer totalisht si kapital në para. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontrubutet e tyre të mëposhtme:

Ortaku themelues Z. Giani RICCARDO: Zotërues i 1 (një) kuote me 50,000 (pesëdhjetë e njëmijë) lekë, që përben 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Ortaku themelues Znj. Flutura NUREDINI: Zotëruese i 1 (një) kuote me 50,000 (pesëdhjetë e njëmijë) lekë, që përben 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

## **Neni 6 – ADMINISTRATORËT**

Shoqëria Tregtare **“G&G Volatili” sh.p.k** ka si Administrator të saj Znj. Flutura NUREDINI e cila ushtron dhe ndjek aktivitetin e shoqërisë duke zbatuar kompetencat përkatëse sipas statutit të shoqërisë.


Afati i emerimit të administratores **Znj. Flutura NUREDINI** do të jetë për një afat 5 (pesë) vjeçar, duke nisur nga dita e nënshkrimit të këtij Akti.

## **Neni 7 – VULA E SHOQËRISË**

Shoqëria ka vulën e saj zyrtare me përmbajtje:  
Shoqëria Tregtare **“G&G Volatili” sh.p.k**

## **Neni 8 - BILANCI DHE TË ARDHURAT**

Viti financiar i Shoqërisë mbyllet në 31 dhjetor të çdo viti.  
Në mbylljen e çdo viti financiar, Administratori i Shoqërisë bën inventarin dhe llogaritë vjetore, në përputhje me dispozitat ligjore mbi kontabilitetin, si dhe harton një raport me shkrim për administrimin.  
Raporti i administrimit, inventarët dhe llogaritë vjetore të hartuara nga Administratori, i nënshtrohen miratimit të Ortakeve brenda një afati prej 6 muajsh, duke filluar nga data e mbylljes së vitit financiar.

## **Neni 9 - SHPËRBËRJA E SHOQËRISË**

Shpërbërja e Shoqërisë Tregtare **“G&G Volatili” sh.p.k** mund të vijë në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkak, duke vepruar sipas kritereve të parashikuara në Statutin e Shoqërisë.

## **Neni 10- DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Ky Akt themelues (kontratë) përpilohet në disa kopje për :

- Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, për të bërë veprimet në Rregjistrin Tregtar.
- Një kopje mbahet nga shoqëria si pjesë e dokumentacionit të themelimit të Shoqërisë Tregtare **“G&G Volatili” sh.p.k**

Ky akt themelimi mbyllet me 10 (dhjetë) nene.

## **SHOQËRIA ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**“G&G Volatili” sh.p.k**

### **ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË**

**Znj. Flutura NUREDINI**

**Z. Giani RICCARDO**

## STATUT

### I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

#### “G&G Volatili” sh.p.k

Në këtë statut,

- "Ligji" është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare";
- "Statuti" është Statuti i shoqërisë;

#### Kreu I

##### Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

##### Neni 1

##### Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

(1) Sot, më 01.06.2021 në, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin “G&G Volatili” sh.p.k

(2) Themeluesit e shoqërisë janë:

- Flutura Nuredini, e bija e Muharemit dhe Kies, lindur në datë 24.01.1970 në Berat, pajisur me Dokument Identifikimi me Nr. 033412568, madhore me zotësi të plotë për të vepruar.
- Giani Riccardo, shtetas italian, i biri i Giovanni dhe Angela, lindur në datë 23.08.1965 në Vimercate, pajisur me Dokument Identifikimi me Nr. AY 4818925, madhor me zotësi të plotë për të vepruar.

##### Neni 2

##### Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

1. Import - eksport i produkteve për dezinfektimin deratizim e dezifektim, pastrim e higjenizim dhe tregëtimi i tyre me shumice dhe pakice.
2. Prodhimi i produkteve dhe paisjeve që shërbejnë për dezifektimin dezisektim dhe deratizim. Prodhimi i produkteve dhe materialeve që shërbejnë për largimin (alontanamento dei pigioni) e zogjeve dhe në vecanti pellumbave
3. Dhënia me qera e mjeteve dhe pajisjeve që shërbejnë për dezinfektimin deratizim e dezifektim, pastrim e higjenizim.



### **Neni 3**

#### **Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e papërcaktuar në kohë.

### **Neni 4**

#### **Selia**

Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga Eduart Mano, Pall 10, Njesia administrative nr 13, Tiranë,

### **Kreu II**

#### **Kapitali**

### **Neni 5**

#### **Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i Shoqërisë Tregtare “**G&G Volatili**” sh.p.k është **100 000** (njëqind mijë) lekë, i cili është nënshkruar dhe shlyer totalisht si kapital në para. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

Ortaku themelues Z. Giani RICCARDO: Zotërues i 1 (një) kuote me 50,000 (pesëdhjetë e njëmijë) lekë, që përben 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Ortaku themelues Zj. Flutura NUREDINI: Zotëruese i 1 (një) kuote me 50,000 (dyzetë e nëntëmijë) lekë, që përben 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

### **Neni 6**

#### **Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.



## Neni 7

### Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

kontributit në kapitalin e shoqërisë;

shitblerjes;

trashëgimisë;

dhurimit;

çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

## Kreu III

### Organet vendimmarrëse dhe drejtuese

## Neni 8


### Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;

- a) ndryshimet e statutit;
- b) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të eksperteve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "d" të kësaj pike;
- e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- f) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së



- veprimtarisë;
- g) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - h) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - i) përfaqësimin e shoqërisë në gjykate dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - j) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - k) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - l) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakeve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

## **Neni 9**

### **Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme**

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakeve, jo me vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

## **Neni 10**


### **Kuorumi**

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit " Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare ", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, më të njëjtin rend dite.

## **Neni 11**



## Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si:

përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;

emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;

emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të eksperteve kontabël të autorizuar;

përcaktimin e shpërblimeve

mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen

e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve tv ecurisë së veprimtarisë;

përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;

miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasyqruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

## Neni 12

### Perjashtimi nga e drejta e votës

1. Ortaku nuk mund të ushtroje të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

vlerësimin e veprimtarisë së tij;

shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;

ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;

dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jete në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.


## Neni 13

### Administrimi

(1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizike si administratore të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit, në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.


(2) Administratorët e një shoqërie tregtare meme, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratore të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

(3) Zj. Flutura NUREDINI do të jetë Administratori i shoqërisë deri në momentin kur Asambleja e Përgjithshme të marrë një vendim për këtë qëllim.



Të dhënat e identifikimit: Nr. 033412568

Specimen i nënshkrimit

  
Zj. Flutura NUREDINI

## Neni 14

### Kompetencat e Administratoreve

Administratorët kanë të drejtë të detyrohen të:

kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;

përfaqësojnë shoqërinë tregtare;

kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarevajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç;

parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratorët janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivitetet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara.

- shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara. Nëse asambleja e përgjithshme emeron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të

marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

## Neni 15

### Përgjegjësitë e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;

të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:



u kthen ortakëve kontributet;

u paguan ortakëve interesa apo dividende;

u shpërndan aktivet shoqërisë;

lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblese nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

## **Kreu IV**

### **Viti financiar-ekspertët**

#### **Neni 16**

#### **Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përfundimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

#### **Neni 17**

#### **Ekspertët**

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

## **Kreu V**

### **Prishja - riorganizimi i shoqërisë**

#### **Neni 18**



## **Prishja dhe likuidimi**

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:  
kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;  
me vendim të Asamblese së Ortakeve;  
me hapjen e procedurave të falimentimit;  
nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";  
me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjëndjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët.

Nëse Ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

### **Neni 19**

#### **Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare."

### **Neni 20**

#### **Baza Ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

### **Neni 21**

#### **Mosmarrëveshjet**

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

**ORTAKËT THEMELUES  
E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**“G&G Volatili” sh.p.k**

**Znj. Flutura NUREDINI**



**Z. Giani RICCARDO**

